



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1372 Prot.

Tiranë, më datë 12.12.2022

VENDIM
Nr. 537, datë 12.12.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.12.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Shoqërisë "Atelier 4" për rishikimin e statusit të Pasurisë Kulturore "Klubi Labëria", shpallur Monument Kulture, kategori e I-rë, me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës nr.1938/1, datë 14.05.1982. Relacioni është i hartuar nga Shoqëria "Atelier 4" e licencuar në restaurim;
 2. Kategorizimin e pasurisë kulturore "Klubi Labëria" nga Monument Kulture, Kategori e I-rë në Monument Kulture, Kategori e II-të;
 3. Miratimin e "Projekt-idesë" për Muzeun Hebraik Shqiptar në Vlorë, me aplikues Shoqërinë "Atelier 4" dhe zhvillues Ministria e Kulturës;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1 dhe 2;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Eugen KALLFANI



Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, nr. 76, Kinostudio, Tiranë, Shqipëri,